



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data

7.4.2021

Nr. Protokollit

3337

Lënda: Njoftim për zhvillimin e procedurës administrative ndaj z. Gentian Picari,
Kryetar i Bashkisë Vorë, për moszbatim të vendimit nr. 140 datë
15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Drejtuar: **KRYETARIT TË BASHKISË VORË**
Z. GENTIAN PICARI

Adresa: Rruga "Unaza", Vlorë

Për Dijeni: **LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM**

Adresa: Rruga "Sami Frashëri"

Ju bëjmë me dije se, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është paraqitur një denoncim me shkrim, nëpërmjet shkresës nr. 2798 prot., datë 29.03.2021, nga Lëvizja Socialiste për Integrim, për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vorë z. Gentian Picari.

Bazuar në këtë denoncim, ju bëjmë me dije se, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ditën e enjte më datë 08.04.2021, ora 14:00, zhvillon seancën dëgjimore për për moszbatim të vendimit nr. 140 datë 15.03.2021 "Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Vorë", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me z. Gentian Picari, me funksion Kryetar i Bashkisë Vlorë.

Bazuar në nenin 47 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e enjte, më datë 08.04.2021, në adresë Rr. Ibrahim Rugova, nr. 4, Tiranë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

